



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

KËSHILLI

VENDIM

Nr. 57 datë 01 / 06 /2018

PËR

**“PAKËSIMIN NË VOLUM DHE HEQJEN NGA FONDI PYJOR PUBLIK TË NJË
SIPËRFAQEJE PREJ 0.091 HA QË NDRYSHON KATEGORINË E PËRDORIMIT
NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË HEC“PRISHTA” NGA SHOQËRIA
“HP PRISHTA 1&2 ENERGY”SH.P.K., NË BASHKINË SKRAPAR”**

Këshilli i Bashkisë Skrapar pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga grupi i punës së Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor në varësi të Bashkisë Skrapar në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54/e, ligjin nr .9385 datë 04.05.2015 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, neni 19, VKM nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive“ pika 45, VKM –në nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM-në nr. 1064, datë 22.12.2010, VKM-në nr.887, datë 19.12.2007 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”, në Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pikat 22, 23, dhe 26, dhe në raportin mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim dhe heqje nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në administrim të Bashkisë Skrapar në funksion të ndërtimit të hec-ëve “Prishta 1, Prishta 2”, si dhe urdherit nr. 263 datë 15.12 2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për vijimin e procedurave për pakësimin në volum dhe heqjen nga fondi pyjor publik të sipërfaqes prej 0,091 ha”.



VENDOSI:

1. Dhënien e pëlqimit për pakësimin në volum dhe heqjen për heqjen nga fondi pyjor publik të sipërfaqes prej: **0.091Ha** të ekonomisë pyjore “Qeshibës-Liqeth, që ndryshon kategorinë e përdorimit në funksion të ndërtimit të HEC “PRISHTA “ .
2. Në vitin e parë të lidhjes së kontratës, “koncesionari” paguan në llogarinë e Bashkisë Skrapar, vlerën prej **470 390 leke** Lekë, për poligonin me sipërfaqen pyjore objekt i ndërtimit të Godinës së Hec-it.
3. Vlera e materialit drusor të llogaritur sipas raportit tekniko ekonomik:eshte **29 270** leke dhe paguhet vetëm një herë.
4. Afati i dhënies në përdorim do të jetë 1 (nje)vit.

Vendimi u miratua me 8 vota pro, — vota kundër — vota abstenim.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.



KRYETARI I KËSHILLIT

Partizan GORÇE

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN PËR NDËRTIMIN E HEC "PRISHTA" nga Shoqëria "HP,PRISHTA 1 & 2 ENERGY" Sh.p.k.

Nr.	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/n/ngast	Siperfaqja qëhiqet nga fondi pyjor/kullosor ha
1	Qeshibës-Liqeth	172a	0.028
2	Qeshibës-Liqeth	195a	0.0315
3	Qeshibës-Liqeth	224a	0.0315
TOTALI			0.091

